



Republika e Maqedonisë së Veriut
MINISTRIA E DREJTËSISË

Në bazë të nenit 35 të Rregullores Gjyqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/13 dhe 114/14), Ministria e Drejtësisë, publikon

SHPALLJE

për kontrollimin e njohurive të kandidatëve për përkthyes të përhershëm gjyqësor

- Kandidati i cili paraqitet, dorëzon **Kërkesë** me taksë administrative të paguar prej 50.00 denar me fletë pagesë/pagesë në POS Terminalin në Ministrinë e Drejtësisë. Në kërkesë duhet të shënohen të dhënat personale (emri, emri i prindit, mbiemri, adresa e banimit, e-mail adresa, telefonin e të ngjashme) dhe për cilën/cilat gjuhë dëshiron të emërohet si përkthyes gjyqësor. Në bashkëngjitje të Kërkesës është i obliguar të dërgon edhe:
 - Certifikatë mbi shtetësinë;
 - Dëshmi për vendbanimin ose vendqëndrimin në rajonin e gjykatës, për të cilin kërkon të vendoset për përkthyes (fotokopje të letër njoftimit/pasaportës ose vërtetim për vendqëndrim);
 - Certifikatë ose diplomë për arsim të lartë të mbaruar (përderisa diploma ose certifikata është e një institucioni të lartë arsimor të huaj, kandidati duhet të dërgon edhe vendim për nostrifikim të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
 - Vërtetim nga institucion i autorizuar arsimor për njohjen aktive të gjuhës maqedonase (vetëm përderisa arsimi i lartë është kryer jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut);
 - Certifikatë ose vërtetim për njohjen aktive të gjuhës së huaj ose gjuhën e pjesëtarëve të bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
 - Fletëpagesa/pagesë në POS Terminalin (për taksë administrative dhe për provimin).
- Çdo kandidat duhet të dorëzojë **fletëpagesë** në shumë prej 6,000,00 denar, të paguar në xhirollogarinë e Ministrisë së Drejtësisë, numër 0700100140 631 12 me shënim "**Për kontrollimin e njohurive për përkthyes gjyqësor**", emri i pranuesit – **Ministria e Drejtësisë**, banka e pranuesit - **Banka Popullore e RM**, llogaria e thesarit të Bankës Popullore nr. 100000000063095, shifra e të hyrave 723013, programi 10/pagesë në POS Terminalin në Ministrinë e Drejtësisë.
- Dokumentet e nevojshme duhet të jenë origjinale ose kopje të vërtetuara te noteri (përveç letër njoftimit) dhe së bashku me Kërkesën të dërgohen në arkivin e **Ministrisë së Drejtësisë, rr. Dimitrie Çupovski, nr. 9 – Shkup**.
- Kontrollimi i njohurive kryhet me shkrim dhe me gojë, në pajtim me Programin për kontrollimin e njohurive të gjuhës tjetër për vendosjen e përkthyesve të përhershëm gjyqësor.
- Programin dhe informatat e tjera për zbatimin e procedurës për kontrollimin e njohurive janë të publikuara në ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë – www.pravda.gov.mk në pjesën për provime.
- Pjesa me shkrim nga kontrollimi i njohurive do të mbahet në periudhën nga **21 deri më 24 prill 2026, duke filluar në orën 9:00, në Ministrinë e Drejtësisë**.
- Kandidati i cili do ta kalojë pjesën e provimit me shkrim për njohjen e gjuhës, i nënshtrohet pjesës së provimit me gojë më së voni në afat prej 7 ditësh pas zbatimit të pjesës së provimit me shkrim.
- Shpallja zgjatë **15 ditë** nga dita e publikimit.